

PLANI LOKAL I VEPRIMIT RINOR 2015 - 2016

me strategjinë pesëvjeçare



Komuna e Ulqinit



PLANI LOKAL I VEPRIMIT RINOR

2015 - 2016

me strategjinë pesëvjeçare



Komuna e Ulqinit



NEW HORIZON
Civil Society Organization

Titulli i publikimit
PLANI LOKAL I VEPRIMIT RINOR 2015-2016

Botuesë
OJQ "Horizonti i Ri"
Komuna e Ulqinit

Publikimin e përgatitën
Nazif Veliqi
Renata Blenishta
Biljana Bevenja

Përkthyesë
Ardita Rama

Dizajn
Arben Husiq

Shtypi
TRIO PRO, Ulqin

FJALA PËRSHËNDETËSE E KRYETARIT TË KOMUNËS

Me qëllim të veprimit sa më efikas dhe cilësor ndaj të rinj, Komuna e Ulqinit ka formuar Grupin punues për hartimin e Planit të Veprimit Rinor, të cilin e përbëjnë përfaqësuesit e vetëqeverisjes lokale, institucioneve publike, sektorit civil dhe vetë të rinjtë.

Dokumenti që gjendet përpara jush, është rezultat i një pune transparente dhe profesionale të këtij ekipi ndërsektorial, i cili ka bashkëpunuar ngushtë me të rinjtë e komunës tonë.

Dëshiroj të shpreh kënaqësinë time që Komuna e Ulqinit, pas shumë vitesh, është orientuar për një planifikim strategjik në këtë fushë. Të rinjtë janë resursi më me vlerë i komunës tonë dhe unë ata i shikoj si pjesëmarrësit më të rëndësishëm në krijimin e të ardhmes më të mirë të Ulqinit.

Vëzhgimet, njohuritë dhe zgjidhjet, problemet dhe nevojat e të rinjve të identifikuar në nivel lokal, kontribuojnë edhe për një kornizë më të plotë dhe gjithëpërfshirëse në nivel shtetëror, prandaj edhe hartimi i Planit Lokal të Veprimit Rinor ka rëndësi të shumëfishtë.

Komuna e Ulqinit deri tani nuk ka pasur një dokument të tillë, i cili do të ketë një rëndësi të veçantë për të rinjtë e Ulqinit, por edhe për Komunën në tërësi.

Dhe në fund, dua të veçanërisht të theksoj se puna nuk mbaron me miratimin e këtij plani, por ky është vetëm fillimi. Plani do të jetë një dokument dinamik, i obligueshëm të zbatohet në periudhën e ardhshme.

Kryetari juaj,
Fatmir Gjeka



FJALA PËRSHËNDETËSE E OJQ-së

Projekti "POLITIKA PËR TË RINJ NË ULQIN" të cilin e realizoi organizata e shoqërisë "Horizonti i Ri", mbështetur nga Fondi për Qytetari Vepruese (FAKT), paraqet vazhdimin e aktiviteteve shumëvjeçare dhe përpjekjeve tona, të cilat kanë për qëllim përfshirjen më të madhe të të rinjve në procesin e vendimmarrjes në nivelin lokal.

Horizonti i Ri ka qenë pjesëmarrës aktiv në hartimin e strategjive, planeve dhe dokumenteve si në nivelin shtetëror ashtu edhe atë lokal. Përndryshe, organizata jonë njihet edhe për përvijën e gjatë në punën me të rinj, përmes programeve të shumta edukative.

Në bazë të këtyre referencave, Horizonti i Ri koordinoi edhe procesin e hartimit të Planit Aksional për Fëmijë për Komunën e Ulqinit (2012-2016).

Hartimi i Planit Shtetëror për të rinj si dhe zbritja e tij në nivel lokal, kanë rëndësi të shumëfishtë për të arritur konsensusin e përgjithshëm shoqëror, respektivisht për të kuptuar pozitat dhe mundësitë e reja të të rinjve që të përfshihen në ndryshimet shoqërore të dëshiruara, përmes zhvillimit të një qasjeje sistematike dhe koherente, identifikimit të nevojave të të rinjve si dhe zgjidhjes së tyre.

Qëllimi i politikës lokale për të rinj është që të përcaktojë se cila është pozita shoqërore e të rinjve në komunitetin tonë dhe çfarë mund të bëjnë institucionet lokale, Qeverisja vendore dhe të gjithë subjektet lokale, për ta përmirësuar këtë pozitë. Me këtë përcaktohet qartë pozita e tanishme, qëllimet (situata e dëshiruara), masat që duhet të ndërmerren si dhe bartësit e aktiviteteve, të cilët do të duhej t'i realizonin dëshirat e parashtruara. Ky Plan, përveç nivelit deklarativ, bëhet edhe një platformë praktike e veprimit shoqëror të Qytetit tonë dhe sistemit politik, në raport me të rinjtë – si një potencial i pashtershëm.

OJQ "HORIZONTI I RI" Ulqin

1. HYRJE

1.1. Çka është Plani Lokal i Veprimit Rinor?

Një nga dokumentet më të rëndësishme që promovon rëndësinë e politikave lokale për të rinj dhe pjesëmarrjen e të rinjve është Karta Evropiane për Pjesëmarrjen e të Rinjve në Jetën Lokale dhe Rajonale, e cila është miratuar që në vitin 1992 dhe që e ka nënshkruar edhe Mali i Zi. Në një nga parimet e Kartës thuhet edhe që vëmendje e veçantë duhet t'i kushtohet pjesëmarrjes së të rinjve nga shtresat e paprivileguara të shoqërisë, duke filluar nga pakicat etnike, nacionale, shoqërore, seksuale, kulturologjike, fetare dhe gjuhësore.

Sipas Kombeve të Bashkuara dhe Bankës Botërore, të rinj quhen personat e moshës 15 deri 24 vjeçare. Në anën tjetër, në territorin e ish Jugosllavisë, kufiri i moshës së të rinjve është shtyrë diçka më lart, për shkak të adoleshencës së zgjatur si pasojë e kushteve më të rënduara për arritjen e pjekurisë shoqërore. Në Mal të Zi me "të rinj" nënkuptohen personat e moshës 15 deri 29 vjeçare. Duke u nisur nga fakti se të rinjtë janë resurs i rëndësishëm për ardhmërinë e çdo shoqërie dhe se në këtë periudhë të jetës merren djepi dhe aftësi personale dhe profesionale kyçe të cilat do të ndikojnë vendosmërisht si në jetën e tyre, ashtu edhe në gjendjen dhe zhvillimin e komunitetit, përkrahja e shoqërisë është shumë e rëndësishme, në mënyrë që ata të bëhen të rritur të lumtur, të suksesshëm, produktivë dhe të pavarur.

Plani Lokal i Veprimit Rinor paraqet një dokument zhvillimor, me të cilin zbatohet kujdesi për të rinjtë me qëllim të përmirësimit të pozitës së të rinjve në komunën tonë.

Ky dokument përcakton politikën gjithëpërfshirëse dhe të harmonizuar ndaj të rinjve dhe planin punues të detyrave për realizimin e Planit të Veprimit. Në interes të të rinjve është që të gjitha njësitë e qeverisjes vendore, institucionet, të gjitha shoqatat e qytetarëve dhe subjektet e tjera të komunitetit shoqëror të kontribuojnë në arritjen e qëllimeve të përbashkëta përmes bashkëpunimit të ndërsjellë dhe veprimit të përbashkët.

Plani Lokal përfshin këto fusha: arsimin, punësimin, shëndetin, familjen, pjesëmarrjen e të rinjve në jetën shoqërore, të drejtat e njeriut, kohën e lirë, kulturën, informimin dhe mobilitetin.

Ky dokument përmban analizën e situatës aktuale (të subjekteve relevante dhe të nevojave të të rinjve) në Ulqin, Planin Strategjik Pesëvjeçar, Planin Njëvjeçar të Veprimit (2014-2015) në të cilin janë cekur problemet e identifikuar, qëllimet dhe aktivitetet për zgjidhjen e problemeve, bartësit e aktivitetëve, afati kohor për realizimin dhe indikatorët (treguesit) e suksesit të realizimit të të gjitha aktivitetëve të paraqitura.

Plani Lokal i Veprimit Rinor i Komunës së Ulqinit është në përputhje me disa dokumente të rëndësishme evropiane dhe botërore, të cilat përcaktojnë drejtimit strategjike të zhvillimit të të rinjve: "Libri i bardhë" (Parlamenti Evropian), "Karta evropiane për pjesëmarrjen e të rinjve në jetën lokale dhe rajonale" (Kongresi i Autoriteteve Lokale dhe Rajonale të Evropës), "Politika shtetërore për të rinj" si dokument punues si dhe shtojca e dokumentit Arsimi i të Rinjve "Deklarata për shekullin XXI", "Njëmbëdhjetë indikatorë për zhvillimin e strategjisë dhe të politikës shtetërore për rini" (të hartuar nga Forumi Rinor Evropian), etj.

Plani Lokal mbështetet dhe është në përputhje me Planin Shtetëror të Veprimit Rinor të Malit të Zi, të cilin e ka miratuar Qeveria e Malit të Zi në vitin 2006, duke bërë që Mali i Zi, pas tre viteve të përpilimit, të fitojë udhëzimet bazë të politikës, në fokus të së cilës janë të rinjtë dhe i cili paraqet strategjinë shtetërore ndaj të rinjve.

2. PLANI I VEPRIMIT 2015-2016

ARSIMI DHE TË RINJTË

Qëllimi: Institucionet arsimore në komunën e Ulqinit në mënyrë efektive identifikojnë dhe u përgjigjen nevojave të të rinjve, duke bashkëpunuar njëkohësisht me institucionet relevante				
Objektivet:	<p>1. Rritja e pranisë së formave të arsimit joformal</p> <p>2. Vullnetarizmi dhe praktika në ndërmarrje me qëllim të njohjes me atmosferën dhe obligimet e punës</p> <p>3. Ngritja e vetëdijes për nevojat për profesione</p> <p>4. Krijimi i kushteve për përfshirjen më të madhe të të rinjve nga grupet e marginalizuara në sistemin e rregullt arsimor</p>			
Objektivi 1: Aktivitetet	Palët përgjegjëse	Indikatorët	Koha e realizimit	Mjetet financiare
Organizimi i kurseve, seminareve, trajnimeve nga fusha të ndryshme nëpër shkolla si pjesë e aktiviteteve jashtëshkollore	Institucionet arsimore; Enti për Punësim; Kompanitë private; OJQ-të	Numri i kurseve dhe seminareve të organizuara për të rinj; Numri i të rinjve të interesuar të marrin pjesë në seminare dhe trajnime të ndryshme	2015-2016 (nga miratimi në Kuvend)	800 €
Informimi më i mirë për kurset ekzistuese	Institucionet arsimore; Kompanitë private; OT; OJQ-të; Mediat	Numri i tabelave informuese të vendosura në vende të dukshme për të rinj; Shkalla e përditësimit të informacioneve për të rinj përmes FB, twitter-it, mediave; Numri i të rinjve të cilët janë informuar përmes rrjeteve të ndryshme sociale dhe mediave	Muaji II – XII (nga miratimi në Kuvend)	200 €
Informimi më i mirë për mundësitë e shkëmbimit të nxënësve dhe shkollave verore jashtë shtetit	Institucionet arsimore Kompanitë private OT OJQ-të Mediat	Numri i tabelave informuese të vendosura në vende të dukshme për të rinj; Shkalla e përditësimit të informacioneve për të rinj përmes FB, twitter-it, mediave; Numri i të rinjve të cilët janë informuar përmes rrjeteve të ndryshme sociale dhe mediave	Muaji II – VII (nga miratimi në Kuvend)	200 €

Objektivi 2:				
Vendosja e bashkëpunimit në mes të Entit për Punësim, shkollave dhe institucioneve, si dhe organizatave të ndryshme rreth mundësive për vullnetarizëm dhe praktikë	Enti për Punësim Institucionet arsimore OJQ-të Kompanitë private	Numri i institucioneve të gatshme për të krijuar hapësira brenda organizatave të tyre për angazhimin e vullnetarëve; Numri i të rinjve të interesuar për vullnetarizëm; Numri i praktikantëve të rinj	Muaji II – XII (nga miratimi në Kuvend)	
Motivimi dhe njohja e të rinjve me përfitimet dhe mundësitë që i ofron ai program	Enti për Punësim Institucionet arsimore Mediat OT OJQ-të	Numri i takimeve dhe trajnimeve të organizuara për vullnetarizëm; Numri i të rinjve të interesuar për vullnetarizëm	Muaji II – XII (nga miratimi në Kuvend)	600 €
Krijimi dhe përditësimi i bazës së të dhënave të vullnetarëve	Qendra Informative OJQ-të Enti për Punësim	Baza e krijuar e të dhënave e cila përditësohet rregullisht	Muaji II – XII (nga miratimi në Kuvend)	
Të futet Enti për Punësim në përshkrimin e punës me qëllim të lidhjes së vullnetarëve me vendet e mundshme të punës	Enti për Punësim OJQ-të	Enti për Punësim përcjell kërkesën dhe me sukses i bashkon vullnetarët me vendet e mundshme të punës përmes bazës së të dhënave; Raportet e Entit për Punësim për numrin e vullnetarëve të cilët kanë kontaktuar dhe të cilët punojnë vullnetarisht në organizata dhe institucione të ndryshme	Muaji II – XII (nga miratimi në Kuvend)	
Objektivi 3:				
Njohja e të rinjve me përfitimet të cilat i ofrojnë drejtimet profesionale	Institucionet arsimore Enti për Punësim OJQ-të	Numri i të rinjve të cilët marrin pjesë në sesione informative të organizuara nga institucionet arsimore për programe dhe drejtime profesionale; Numri i të rinjve të cilët regjistrohen në drejtime profesionale	Muaji II – XII (nga miratimi në Kuvend)	300 €
Hulumtimi periodik i tregut të punës në lidhje me profesionet	Enti për Punësim OJQ-të	Numri i hulumtimeve në nivel vjetor	Muaji II – XII (nga miratimi në Kuvend)	600 €

Inicimi i programit të bashkëpunimit të shkollave profesionale me biznesin (kompanitë dhe firmat), ku nxënësit do të kishin mundësinë që të mësojnë në praktikë	Institucionet arsimore Enti për Punësim Kompanitë e biznesit OJQ-të	I nënshkruar Memorandumi për Bashkëpunim në mes të institucioneve arsimore dhe kompanive ku do të realizohej praktika e nxënësve; Raportet për trajnimin e avancuar praktik të pjesëmarrësve	Muaji II – XII (nga miratimi në Kuvend)	
Hartimi i planit dhe programit detal të punës praktike të nxënësve të shkollave të mesme profesionale	Institucionet arsimore në bashkëpunim me ofruesit e këtij shërbimi (sipërmarrësit)	Numri dhe cilësia e planeve të hartuara për aftësimin praktik të nxënësve	Muaji II – XII (nga miratimi në Kuvend)	
Ndjekja dhe monitorimi i procesit të punës përmes mbajtjes së portofolit për çdo nxënës që bën punën praktike	Institucionet arsimore në bashkëpunim me ofruesit e këtij shërbimi (sipërmarrësit) OJQ-të	Cilësia e praktikës së realizuar Indikatorët nga portofolet e nxënësve	Muaji II – XII (nga miratimi në Kuvend)	
Rregullimi i hapësirave në Shkollën e Mesme të Përzier për kryerjen e praktikës (kafeneja, organizimi i kateringut etj.)	Ministria e Arsimit Institucionet arsimore Vetëqeverisja lokale	Raporti për shfrytëzimin e hapësirave për kryerjen e praktikës gjatë mësimit; Raporti nga evaluimet e nxënësve për cilësinë dhe aftësitë e fituara gjatë praktikës dhe rekomandimet për përmirësim	Muaji II – XII (nga miratimi në Kuvend)	10.000 €
Objektivi 4:				
Organizimi i trajnimeve për stafin mësimdhënës dhe udhëheqësinë e shkollës me temën e arsimit gjithëpërfshirës dhe reduktimi i paragjytimeve	Ministria e Arsimit Enti për Arsim OJQ-të	Numri i trajnimeve të organizuara për stafin mësimdhënës dhe udhëheqësinë e shkollës; Raporti i trajnerëve nga trajnimet; Numri i të rinjve pjesëtarë të grupeve të marginalizuara të cilët u nxitën të ndjekin mësimin	Një herë në vit	500 €
Organizimi i punëtorive për nxënës të shkollave të mesme me temën e pranimit të diversitetit, të drejtave të njeriut, dhe luftës kundër të gjitha formave të diskriminimit	Shkollat Mësimdhënësit OJQ-të	Numri dhe cilësia e punëtorive të organizuara; Raporti i facilitatorëve të punëtorive; Raporti nga vlerësimet e pjesëmarrësve të punëtorive	Vazhdimisht	500 €

Futja e arsimit gjithëpërfshirës në shkollat e mesme, përshtatja e infrastrukturës së shkollave, përshtatja e programit mësimor që promovon pranimin, diversitetin dhe interkulturalizmin.	Ministria e Arsimit Enti për Arsimit OJQ-të	Vlerësimet duke përdorur Indeksin për Gjithëpërfshirje si metodë të hulumtimit të gjithëpërfshirjes së shkollës; Numri i Planeve Individuale Zhvillimore dhe Arsimore (të hartuara); Numri dhe cilësia e programeve të përshtatura	Vazhdimisht	1000 €
--	---	--	-------------	--------

PUNËSIMI DHE TË RINJTË

Qëllimi: Sistemi i punësimit në komunën e Ulqinit u ofron mundësi të rinjve që të jenë konkurrues në tregun e punës				
Objektivet:	<ol style="list-style-type: none"> 1. Rritja e informimit të të rinjve për mundësitë e rikualifikimit 2. Harmonizimi dhe lidhja e ofertës dhe kërkesës për punët afatshkurta dhe ato sezonale 3. Rritja e informimit, motivimit dhe përkrahjes së sipërmarrësve të rinj, por edhe njohja e sipërmarrësve për lehtësimet tatimore dhe ligjore të punësimit të personave nga kategoritë e caktuara 			
Objektivi 1: Aktivitetet	Palët përgjegjëse	Indikatorët	Koha e realizimit	Mjetet financiare
Realizimi i hulumtimeve periodike të nevojave të tregut të punës në Ulqin	Enti për Punësim OJQ-të	Numri i hulumtimeve të realizuara; Cilësia e informacioneve të fituara; Numri i të rinjve të përfshirë në hulumtime	Dy herë në vit	600 €
Lidhja e institucioneve dhe sektorit të biznesit me qëllim të kryerjes së praktikës në kuadër të programit të rikualifikimit gjegj. avancimit profesional	Enti për Punësim Institucionet arsimore Sektori i biznesit dhe organizatat ku kryhet praktika OJQ-të	Numri i kontratave të lidhura në mes të Entit për Punësim dhe sektorit të biznesit; Numri i praktikave të realizuara; Numri i të rinjve të përfshirë në programet e rikualifikimit gjegj. avancimit profesional; Numri i të rinjve të punësuar pas kryerjes së praktikës; Zvogëlimi i numrit të të rinjve të papunësuar	Vazhdimisht	
Përditësimi i rregullt i tabelës së lajmërimeve nëpër zyra dhe lajmërimeve online për ofertat për kurse dhe punë (Enti për Punësim + institucionet arsimore)	Enti për Punësim Institucionet arsimore Mediat OJQ-të	Cilësia e informacioneve në tabelën e lajmërimeve dhe platformat online; Numri i të rinjve të cilët informohen rregullisht përmes mediave të lartpërmendura	Vazhdimisht	

Futja e programeve të reja të rikualifikimit për të rinj në raport me kërkesat e tregut të punës	Enti për Punësim Sektori i biznesit OJQ-të	Numri i programeve të realizuara; Numri i pjesëmarrësve; Zvogëlimi i numrit të të rinjve të papunë	Muaji IX – XII	1000 €
Objektivi 2:				
Vendosja e bashkëpunimit të vazhdueshëm dhe intensiv në mes të Entit për Punësim dhe institucioneve të tjera relevante në komunë	Enti për Punësim Sektori i biznesit Qendra për Punë Sociale Institucionet arsimore OT	Numri i partneriteteve të krijuara dhe cilësia e bashkëpunimit; Numri i iniciativave të ndërmarra me përpjekje të përbashkët të institucioneve; Numri i të rinjve të cilët patën përfitime nga bashkëpunimi i institucioneve	Vazhdimisht	
Informimi i punëdhënësve për mundësitë e angazhimit të vullnetarëve dhe punëtorëve sezonalë	Enti për Punësim OT OJQ-të	Numri i kontakteve të realizuara të Entit për Punësim me sektorin e biznesit; Numri i vullnetarëve dhe i të rinjve në punë sezonale gjatë vitit 2015	2015-2016	
Objektivi 3:				
Organizimi i trajnimit për të rinjtë, sipërmarrës të ardhshëm me temë të hartimit të planeve të biznesit dhe aplikimit për kredi biznesi	Enti për Punësim OJQ-të Qendra e Biznesit Qendra për Ndërmarrësi Bankat	Numri i trajnimeve të realizuara; Numri i të rinjve të kyçur në trajnime; Numri dhe cilësia e planeve të krijuara të biznesit; Numri i iniciativave të nisura; Shuma e kredive të dhëna për sipërmarrës të rinj	Muaji V – XII	2000 €
Organizimi i aktiviteteve motivuese për të rinj me qëllim të nxitjes së frymës sipërmarrëse dhe inovacionit	Enti për Punësim OJQ-të Mediat, Institucionet arsimore	Numri i aktiviteteve të organizuara; Numri i të rinjve të kyçur në trajnime; Numri i të rinjve të interesuar për themelimin e biznesit të vet pas trajnimit	Muaji IV – XII	1500 €
Informimi i punëdhënësve për lehtësimet tatimore dhe të tjera përmes punësimit të kategorive të caktuara të personave që punësohen më vështirë	Enti për Punësim Dhoma e Tregtisë Shoqatat e biznesit	Numri i të rinjve të punësuar nga kategoritë e personave që punësohen më vështirë	Vazhdimisht	

SHËNDETI DHE TË RINJTË

Qëllimi: Krijimi i shërbimeve të reja shëndetësore dhe sigurimi i qasjes më të madhe në ato ekzistuese që janë të orientuara kah të rinjtë / me theks të veçantë te të rinjtë në rrezik				
Objektivet:	1. Rritja e nivelit të vetëdijes së të rinjve për stilet e shëndosha të jetës 2. Rritja e nivelit të informimit të të rinjve për sëmundjet e varësisë 3. Rritja e nivelit të vetëdijes së të rinjve për rëndësinë e planifikimit familjar dhe të qenët prind i përgjegjshëm 4. Përmirësimi i qasjes së të rinjve në sistemin shëndetësor			
Objektivi 1: Aktivitetet	Palët përgjegjëse	Indikatorët	Koha e realizimit	Mjetet financiare
Informimi i të rinjve për stilet e shëndosha të jetës përmes mediave, rrjeteve sociale, materialeve propaganduese	Shtëpia e Shëndetit Mediat OJQ-të Institucionet arsimore	Numri dhe cilësia e të rinjve të informuar përmes mediave, rrjeteve sociale dhe materialit propagandues	Muaji II – XII	1500 €
Organizimi i punëtorive, konferencave seminarëve për promovimin e stileve të shëndosha të jetës	OJQ-të Institucionet arsimore Shtëpia e Shëndetit	Numri i punëtorive, konferencave dhe seminarëve të organizuara; Numri i të rinjve pjesëmarrës	Muaji II – XII	2000 €
Promovimi dhe përmirësimi i cilësisë së punës së Këshillimores për të Rinj në Shtëpinë e Shëndetit	Shtëpia e Shëndetit Ministria e Shëndetësisë	Numri i shërbimeve të cilat i ofrohen të rinjve; Numri i të rinjve shfrytëzues të shërbimeve të Këshillimores; Cilësia e shërbimeve; Raporti Vjetor i punës së Këshillimores	Muaji II – XII	
Objektivi 2:				
Organizimi i prezantimeve, punëtorive, seminarëve për të rinj dhe prindër për sëmundjet e varësisë	Institucionet arsimore Shtëpia e Shëndetit Policia OJQ-të	Numri i punëtorive, konferencave, seminarëve të organizuara; Numri i të rinjve pjesëmarrës	Muaji II – XII	500 €
Hartimi i materialit propagandues për sëmundjet e varësisë	OJQ-të Shtëpia e Shëndetit Institucionet arsimore	Sasia e materialit të hartuar dhe të shpërndarë; Numri i të rinjve të informuar në këtë mënyrë	Muaji II – XII	500 €
Rritja e pjesëmarrjes së të rinjve në konferencat dhe seminarët rajonale të cilat trajtojnë dhe merren me parandalimin e sëmundjeve të varësisë	OJQ-të Shtëpia e Shëndetit Institucionet arsimore	Numri i të rinjve pjesëmarrës; Cilësia e bashkëpunimeve të arritura me organizatat dhe institucionet në rajon dhe më gjerë	Muaji II – XII	1000 €

Objektivi 3:				
Organizimi i informimit të të rinjve për rëndësinë e planifikimit familjar dhe përgjegjësinë e prindërve (në shkolla dhe në Shtëpinë e Shëndetit)	OJQ-të Shtëpia e Shëndetit Institucionet arsimore	Numri i sesioneve informuese Numri i të rinjve pjesëmarrës në sesione	Muaji II – XII	700 €
Përgatitja dhe shpërndarja e materialit propagandues	OJQ-të Shtëpia e Shëndetit Institucionet arsimore	Tirazhi i materialit të hartuar; Numri i të rinjve të cilat kanë përfitime nga materiali edukativ	Muaji XII	500 €
Objektivi 4:				
Formimi i grupit punues profesional për përkrahje të familjes	Shtëpia e Shëndetit Ministria e Punëve të Brendshme Qendra për Punë Sociale Shkollat Të rinjtë OJQ-të	Grupi i formuar multidisiplinar i ekspertëve; Numri i ndërhyrjeve të ekipit multidisiplinar	Muaji II – XII	
Edukimi dhe trajnimi i personelit mjekësor për punë me të rinjtë	Ministria e Shëndetësisë OJQ-të Shtëpia e Shëndetit	Numri i trajnimeve të realizuara; Njohuritë dhe aftësitë e reja të fituara gjatë trajnimeve	Muaji II – XII	1000 €

FAMILJA DHE TË RINJTË

Qëllimi: Familja, si njësi themelore për funksionimin e shoqërisë dhe të rinjtë në Ulqin kanë mekanizma adekuate përkrahjeje për kapërcimin e faktorëve të cilët ndikojnë në mosfunksionimin e familjes				
Objektivet:	<ol style="list-style-type: none"> 1. Rritja e nivelit të vetëdijes së të rinjve për rëndësinë e planifikimit familjar me theks të veçantë në përkrahjen e prindërve të rinj vetushqyes 2. Zvogëlimi i shkallës së dhunës dhe diskriminimit në familje dhe rritja e përgjegjësisë së anëtarëve të familjes 3. Forcimi i kapaciteteve të institucioneve për dhënie të përkrahjes familjeve në komunën e Ulqinit 			
Objektivi 1: Aktivitetet	Palët përgjegjëse	Indikatorët	Koha e realizimit	Mjetet financiare
Organizimi i trajnimeve dhe tribunave për të rinj në lidhje me planifikimin familjar	Shtëpia e Shëndetit OJQ-të Komuna e Ulqinit Qendra për Punë Sociale	Numri i trajnimeve të realizuara; Numri i të rinjve të përfshirë në trajnime; Njohuritë dhe aftësitë e fituara gjatë trajnimeve	Muaji IX – XII	300 €

Organizimi i aksioneve me qëllim të përkrahjes (materiale, sociale, psikologjike) së prindërve të rinj vetushqyes	Qendra për Punë Sociale OJQ-të Komuna e Ulqinit Të rinjtë Mediat	Numri i aksioneve të realizuara; Numri i prindërve të rinj të përfshirë në aksione; Standardi i jetës dhe integrimi në shoqëri i prindërve të rinj vetushqyes	Muaji II – X	500 €
Organizimi i ligjëratave në shkolla për identitetin seksual dhe gjinor, ndërtimin e marrëdhënieve të bazuara në themele të shëndosha dhe për barazinë gjinore	Institucionet arsimore OJQ-të Qendra për Punë Sociale Shtëpia e Shëndetit	Numri i ligjëratave të realizuara; Numri i të rinjve të cilët i kanë ndjekur ligjëratat; Zvogëlimi i numrit të rasteve të dhunës në bazë të gjinisë	Muaji II – XII	700 €
Objektivi 2: Aktivitetet				
Realizimi i hulumtimit i cili do të trajtonte vlerësimin e shkallës së dhunës dhe diskriminimit në familje	OJQ-të Qendra për Punë Sociale Ministria e Punëve të Brendshme	Hulumtimi i realizuar; Numri i të anketuarve gjatë hulumtimit; Cilësia e informatave të fituara	Maj 2015	600 €
Krijimi i planit të veprimit të ndërhyrjeve në bazë të rezultateve të hulumtimit	Ministria për Punë të Brendshme Qendra për Punë Sociale OJQ-të Institucionet arsimore	Plani i krijuar i veprimit; Bashkëpunimi i vendosur ndërsektorial; Aktivitetet e realizuara të cekura në Planin e Veprimit	Muaji VII – XII	
Realizimi i programeve edukative për të rinj me temën e diskriminimit dhe gjuhës së urrejtjes	OJQ-të Institucionet arsimore	Numri i programeve të realizuara; Numri i të rinjve të përfshirë në programe; Shkalla e dhunës dhe gjuhës së urrejtjes në mesin e të rinjve pas trajnimeve	Muaji IX – XII	2000 €
Objektivi 3: Aktivitetet				
Organizimi i trajnimeve për profesionistë të cilët merren me dhënien e përkrahjes familjes në situata krize	Qendra për Punë Sociale Ministria e Punëve të Brendshme Shtëpia e Shëndetit OJQ-të Mediat	Numri dhe cilësia e trajnimeve të realizuara; Numri i pjesëmarrësve në trajnime; Njohuritë dhe aftësitë e fituara për dhënien e përkrahjes familjes; Shkalla e kënaqshmërisë së familjeve në komunën e Ulqinit për punën e institucioneve në fushën e parandalimit të dhunës dhe të mbrojtjes së të drejtave	Muaji IX – XII	1500 €

Rritja e dukshmërisë të Këshillimores në Ulqin përmes reklamave, shpërndarjes së fletëpalosjeve promovuese, vizitave në shkolla etj.	Shtëpia e Shëndetit Komuna e Ulqinit OJQ-të Mediat Institucionet arsimore	Këshillimorja më e dukshme; Numri i rritur i vizitave në Këshillimore; Cilësia më e mirë e shërbimeve të Këshillimores dhe më afër qytetarëve	Muaji III – XII	2000 €
Vendosja e komunikimit më të ngushtë ndërsektorial ndërmjet institucioneve të cilat i ofrojnë përkrahje familjes në komunën e Ulqinit	Ministria për Punë të Brendshme Shtëpia e Shëndetit Komuna e Ulqinit Qendra për Punë Sociale OJQ-të Mediat Institucionet arsimore	Të nënshkruar Memorandumet për Bashkëpunim; Numri i ndërhyrjeve të përbashkëta; Cilësia e ndërhyrjeve nëpër familje		

KULTURA DHE TË RINJTË

Qëllimi: Kushtet e siguruara për një përmbajtje cilësore kulturore për të rinj dhe me të rinjtë				
Objektivet:	1. Përkrahje institucionale për të rinjtë me ide nga fusha e kulturës 2. Rritja e informimit për ngjarjet kulturore 3. Promovimi i talenteve të rinj në komunën e Ulqinit			
Objektivi 1: Aktivitetet	Palët përgjegjëse	Indikatorët	Koha e realizimit	Mjetet financiare
Hulumtimi i nevojave dhe interesimeve të të rinjve në fushën e kulturës	Qendra për Kulturë OJQ-të	Numri i hulumtimeve dhe i raporteve për nevojat dhe interesimet e të rinjve	Një herë në vit	300 €
Krijimi i hapësirës për realizimin e ideve dhe interesimeve të të rinjve	Qendra për Kulturë Institucionet arsimore	Hapësira e siguar që përdoret për organizimin e aktiviteteve të ndryshme; Numri i të rinjve të cilët e përdorin hapësirën	Muaji II – XII	3000 €
Stimulimi i të rinjve për të eksploruar talentet dhe aftësitë e tyre	Qendra për Kulturë Institucionet arsimore	Numri dhe cilësia e ngjarjeve dhe konkurseve të organizuara; Numri i të rinjve të cilët paraqiten në konkurse	Vazhdimisht	
Organizimi i punëtorive për rritjen e motivimit të të rinjve për t'u angazhuar në krijimin e përmbajtjeve të reja kulturore për të rinj	Qendra për Kulturë Institucionet arsimore OJQ-të	Numri dhe cilësia e punëtorive të organizuara; Numri i të rinjve që marrin pjesë në punëtori	Muaji II – XII	2500 €

Objektivi 2:				
Vendosja dhe përditësimi i tabelave me informacione për ngjarjet kulturore	Vetëqeverisja lokale Qendra për Kulturë Institucionet arsimore	Numri i tabelave të vendosura informuese; Numri i të rinjve që informohen	Muaji II – XII	500 €
Përditësimi i informacioneve për ngjarjet për të rinjtë në kuadër të faqes së internetit të komunës së Ulqinit	Vetëqeverisja lokale Qendra për Kulturë Institucionet arsimore	Numri dhe cilësia e informacioneve të vendosura; Numri i vizitorëve	Muaji II – XII	
Vendosja e informacioneve për të rinj në faqet e FB	Vetëqeverisja lokale Qendra për Kulturë Institucionet arsimore	Numri dhe cilësia e informacioneve të vendosura; Numri i të rinjve të cilët në mënyrë aktive informohen përmes përmbytjeve të vendosura	Muaji II – XII	
Informimi i të rinjve përmes Qendrës së Informimit	Qendra për Kulturë Institucionet arsimore	Numri i të rinjve të cilët janë të kyçur në mënyrë aktive në realizimin e përmbytjeve kulturore	Muaji II – XII	
Objektivi 3:				
Organizimi i garave për nxitjen e talenteve të reja	Qendra për Kulturë Institucionet arsimore OJQ-të	Numri i garave të organizuara; Afirmimi i talenteve të reja Përkrahja e siguruar e të rinjve për angazhimin e mëtejshëm në aktivitete rekreative dhe kulturore	Muaji II – XII	7500 €

KOHA E LIRË E TË RINJVE

Qëllimi: Komuniteti bashkë me të rinjtë ofron përmbajtje cilësore për kohën e lirë				
Objektivet:	<p>1. Sigurimi i kushteve për realizimin e ngjarjeve sportive dhe kulturore</p> <p>2. Rritja e pjesëmarrjes së të rinjve në krijimin e përmbajtjeve për aktivitete të lira dhe atyre kulturore</p> <p>3. Niveli i rritur i edukimit joformal dhe i socializmit të të rinjve</p>			
Objektivi 1: Aktivitetet	Palët përgjegjëse	Indikatorët	Koha e realizimit	Mjetet financiare
Përshtatja e hapësirave në Qendrën për Kulturë për aktivitete të lira, përmbajtje kulturoro-artsitike dhe për përkrahje të iniciativave të të rinjve	Vetëqeverisja lokale Sektori për Sport dhe Kulturë	Hapësira e përshtatur në Qendrën për Kulturë; Numri i aktiviteteve të cilat organizohen në Qendër; Numri i të rinjve të cilët janë të kyçur në punën e Qendrës; Numri i të rinjve të cilët janë të kyçur në aktivitete të lira	Muaji II – XII	3000 €
Organizimi i turneve sportive në nivel komunal -ndeshje futbollit, basketboll, not, (gjatë sezonit), pingpong, tenis, futboll tavoline, pikado elektronike, maratonë etj.	Vetëqeverisja lokale Qendra për Kulturë OJQ-të Shkollat	Numri i ndeshjeve të organizuara të futbollit; Numri i ndeshjeve të organizuara të basketbollit; Numri i turneve të organizuara në tenis dhe pingpong; Numri i aktiviteteve të tjera sportive të organizuara; Numri i të rinjve të kyçur në vetë organizimin e ngjarjeve sportive	Muaji I – XII	9000 €
Inicimi i seksioneve të ndryshme kulturore	Shkollat Mësimdhënësit Të rinjtë Qendra për Kulturë	Numri i seksioneve dhe aktiviteteve jashtëshkollore të organizuara nëpër shkolla; Numri i seksioneve të organizuara në Qendrën për Kulturë; Numri i të rinjve të cilët ndjekin seksione të ndryshme në shkolla dhe në Qendrën për Kulturë	Muaji II – XII	
Objektivi 2:				
Nxitja e zhvillimit të vullnetarizmit. Formimi i grupeve vullnetare (Këshilli i të Rinjve)	OJQ-të Shkollat Vetë nxënësit	Numri i klubeve vullnetare të themeluara në komunën e Ulqinit; Numri i të rinjve të kyçur në aksione vullnetare	Muaji II – XII	

Organizimi i aktiviteteve për të rinj, këndit për të rinj, në kuadër të institucioneve (arsimore, Qendrës për Kulturë, OJQ-ve)	Të rinjtë Shkollat Qendra për Kulturë OJQ-të	Numri dhe cilësia e aktiviteteve të organizuara për të rinj; Numri i të rinjve të cilët ndjekin dhe janë të kyçur në këto aktivitete	Muaji II - XII	
Promovimi i vullnetarizmit duke shënuar Ditën Ndërkombëtare të Vullnetarizmit	OJQ-të Komuna Shkollat Të rinjtë	Kremtimi i organizuar i Ditës së Vullnetarizmit; Numri i të interesuarve për t'u bërë vullnetarë; Numri i të rinjve të kyçur në organizimin e Ditës së Vullnetarizmit	5 dhjetor	500 €
Objektivi 3:				
Inicimi i themelimit të Klubit të Rinisë	Vetëqeverisja lokale OJQ-të Qendra për Kulturë	Qeverisja lokale e interesuar për themelimin e Klubit të Rinisë; I nënshkruar Memorandumi për Bashkëpunim ndërmjet palëve të interesuara për themelimin e Klubit të Rinisë	Muaji II - XII	
Organizimi i kurseve (matematikë, gjuhë të huaja, rrobaqepësi, punë kreative, art craft, pikturë etj.)	Shkollat OJQ-të	Shkollat tregojnë interesim që t'i sigurojnë nxënësve të vet kurse falas; Numri i kurseve të organizuara; Numri i të rinjve të kyçur në kurse të ndryshme	Muaji II - XII	3000 €
Organizimi i seminareve për tema të ndryshme interesante dhe të nevojshme për të rinjtë në komunën e Ulqinit	Shkollat Qendra për Kulturë OJQ-të	Numri i seminareve cilësore të organizuara për të rinj; Numri i të rinjve të interesuar të ndjekin seminarët	Muaji II - XII	1000 €

TË DREJTAT E NJERIUT DHE TË RINJTË

Qëllimi: Të gjithë të rinjtë në komunën s Ulqinit, pjesëtarë të shumicës dhe pakicës, të integruar në jetën shoqërore të komunës				
Objektivet:	1. Rritja e informimit të të rinjve në lidhje me të drejtat e tyre 2. Rritja e pjesëmarrjes aktive të të rinjve në fushën e mbrojtjes dhe promovimit të të drejtave dhe lirive të njeriut 3. Promovimi i diversitetit dhe zvogëlimi i paragjytimeve në mesin e të rinjve të Ulqinit			
Objektivi 1: Aktivitetet	Palët përgjegjëse	Indikatorët	Koha e realizimit	Mjetet financiare
Themelimi i Zyrës për të Rinj, e cila ndër të tjera do të trajtonte monitorimin e respektimit dhe mbrojtjen e të drejtave të të rinjve në komunën e Ulqinit	Komuna e Ulqinit Qendra për Punë Sociale OJQ-të	Hapësira dhe kushtet e siguruara për punën e Zyrës; Qëllimet dhe aktivitetet e definuara të punës së Zyrës; Komunikimi i vendosur i Zyrës me institucionet relevante lokale dhe shtetërore	Muaji X	2000 €
Hartimi i materialit promovues për të drejtat dhe mënyrat e mbrojtjes së të drejtave, si dhe sanksionet për shkeljen e të drejtave	OJQ-të Institucionet arsimore Ministria e Punëve të Brendshme Mediat	Tirazhi i materialit të hartuar promovues; Përmbajtja e përfshirë në publikime; Numri i të rinjve të informuar në këtë mënyrë		600 €
Organizimi i punëtorive edukative për të rinj me temën e të drejtave të njeriut	OJQ-të	Numri i punëtorive të realizuara; Numri i të rinjve të kyçur në punëtori; Numri i iniciativave të lindura pas punëtorive	Muaji II – XII	2000 €
Lidhja në nivel shtetëror e Zyrës së Ulqinit dhe zyrave të tjera për të rinj në Malin e Zi	Zyra për të Rinj Komuna e Ulqinit	Numri i vizitave të realizuara zyrave të tjera Numri i partneriteteve të vendosura	Muaji X – XII	
Objektivi 2:				
Formimi i rrjetit të edukatorëve moshatarë nëpër shkolla të cilët ndjekin respektimin e të drejtave të nxënësve	Institucionet arsimore OJQ-të	Numri i të rinjve të kyçur në punën e rrjetit të edukatorëve moshatarë; Numri i mësimeve të kyçur në iniciativë; Numri i aktiviteteve të realizuara të rrjetit të moshatarëve; Numri i nxënësve të përfshirë në punën e rrjetit	Muaji III – XII	
Objektivi 3:				
Organizimi i ngjarjeve publike me qëllim të përhapjes së tolerancës dhe pjesëmarrjes së të rinjve të të gjitha grupeve	OJQ-të Qendra për Kulturë Shkollat	Numri i ngjarjeve të organizuara; Numri i të rinjve të cilët kanë marrë pjesë në këto ngjarje; Ndikimi në publikun e gjerë	Muaji IX – XII	1000 €

PJESËMARRJA E TË RINJVE NË JETËN E SHOQËRISË

Qëllimi: Të rinjtë e komunës së Ulqinit marrin pjesë aktive në aktivitetet e komunitetit lokal, të cilat i përkasin atyre				
Objektivet:	1. Rritja e motivimit të të rinjve për t'u kyçur në ngjarjet e komunitetit 2. Krijimi i mekanizmave dhe hapësirave adekuate për pjesëmarrjen e të rinjve			
Objektivi 1: Aktivitetet	Palët përgjegjëse	Indikatorët	Koha e realizimit	Mjetet financiare
Formimi dhe motivimi i grupeve vullnetare të të rinjve me qëllim të promovimit dhe rëndësisë së vullnetarizmit	Shkollat OJQ-të	Numri i grupeve vullnetare të koordinuara; Numri i të rinjve të cilët kyçen dhe krijojnë aksione vullnetare; Numri i iniciativave të nisura nga vullnetarët Kursimi i buxhetit i realizuar me angazhimin vullnetar të të rinjve; Vlerësimi i kompetencave të të rinjve të fituara me angazhim vullnetar	Muaji II – XII	
Organizimi i konkurseve, garave, afirmimi i të rinjve të talentuar përmes festivaleve dhe takimeve të të rinjve	Qeverisja lokale Shkollat OJQ-të	Numri i ngjarjeve të organizuara, Numri i të rinjve të cilët kanë marrë pjesë në organizimin dhe realizimin e ngjarjeve; Cilësia dhe suksesi i të arriturave të të rinjve gjatë garave dhe festivaleve	Muaji III – XII	15000 €
Organizimi i seminareve dhe programeve të orientimit dhe përsosjes profesionale të njohurive dhe aftësive të të rinjve në komunën e Ulqinit	Qeverisja lokale Shkollat OJQ-të	Numri i programeve të organizuara arsimore; Numri i të rinjve të interesuar për programet e ofruara; Kompetencat e të rinjve të fituara gjatë trajnimeve	Muaji II – XII	3000 €
Objektivi 2:				
Lobimi dhe avokimi për përfshirje më të madhe të të rinjve në fushëveprimin e punës së institucioneve në komunën e Ulqinit (kultura, sporti, arsimit, turizmi...)	Komuna e Ulqinit Institucionet Organizatat e sektorit civil Mediat Të rinjtë	Numri i fushatave të realizuara të avokimit dhe lobimit; Suksesi i fushatave të kryera; Numri i institucioneve të përfshira me fushata dhe cilësia e ofertave të reja të institucioneve për të rinj	Muaji IX – XII	
Lobimi dhe avokimi për kontribut më të madh të sektorit të biznesit në komunën e Ulqinit gjatë procesit të kyçjes së të rinjve në vendimmarrje	Organizatrat e sektorit civil Kompanitë Mediat Të rinjtë	Numri i iniciativave të nisura kah sektori i biznesit; Numri i sipërmarrësve dhe ndërmarrjeve të gatshme për kyçje direkte të të rinjve në procesin e vendimmarrjes	Muaji II – XII	

Organizimi i diskutimeve – debateve në nivel lokal dhe shtetëror me temën pjesëmarrja e të rinjve	OJQ-të Të rinjtë Zyra për të Rinj	Numri i ngjarjeve të organizuara; Rekomandimet nga ngjarjet; Numri i bashkëpunimeve të vendosura; Shembuj të praktikës së mirë në MZ		
Hapja e Qendrës Rinore në Ulqin	Komuna e Ulqinit OJQ-të Mediat Sektori i biznesit Të rinjtë	Hapësira e siguruar për Qendrën Rinore; Plani i krijuar i ofertës së Qendrës Rinore; Standardet e vendosura të punës së Qendrës Rinore; Numri i aktiviteteve të realizuara të Qendrës; Numri i të rinjve nga komuna e Ulqinit të kyçur në punën e Qendrës Rinore	Muaji IX – XII	5000 €

INFORMIMI DHE MOBILITETI

Qëllimi: Të rinjtë e Ulqinit janë të njoftuar me mundësitë në nivel lokal, shtetëror dhe global				
Objektivet:	<ol style="list-style-type: none"> 1. Inicimi i hapjes së shërbimit për informim të të rinjve 2. Numri i rritur i emisioneve në mediat lokale lidhur me të rinjtë 3. Rritja e mobilitetit të të rinjtë e Ulqinit 			
Objektivi 1: Aktivitetet	Palët përgjegjëse	Indikatorët	Koha e realizimit	Mjetet financiare
Formimi i faqes së internetit e cila do të përfshinte të gjitha informatat relevante për të rinjtë e Ulqinit	Komuna e Ulqinit OJQ-të Të rinjtë e Ulqinit Institucionet	Faqja e krijuar e internetit; Përmbajtja e përmbledhur që i përket të rinjve; Përditësimi i rregullt i të dhënave; Numri i vizitave të faqes, të shkarkimit të dokumenteve etj.	Muaji III	(faqja për të rinj në kuadër të sajtit ekzistues të Komunës së Ulqinit)
Hapja e Qendrës Informative	Komuna e Ulqinit Qendra për Kulturë OJQ-të Të rinjtë	Hapësira e siguruar për Qendrën Informative; Pajisja e siguruar për funksionimin e Qendrës Informative; Personi i punësuar në Qendrën Informative; Bazat e përditësuara të të dhënave; Lidhja e Qendrës Informative me institucionet dhe organizatat e tjera	Muaji X	3000 €

Krijimi i Planit të Punës së Qendrës Informative	Qendra Informative OJQ-të Të rinjtë Institucionet	Ekzistimi i sesioneve të hapura për informimin e të rinjve; Numri i vizitave Qendrës Informative; Numri i materialeve të shpërndara promovuese; Numri dhe cilësia e ngjarjeve të organizuara në Qendrën Informative	Muaji IX- XII	
Objektivi 2:				
Krijimi i emisioneve për të rinj në mediat lokale	Mediat lokale (TV Teuta, Radio Ulqini, Radio Elita) Të rinjtë Shkollat e mesme OJQ-të	Numri i emisioneve të reja të krijuara për dhe me të rinjtë; Bashkëpunimi i realizuar ndërmjet mediave lokale dhe institucioneve arsimore në komunë; Shikueshmëria gjegj. dëgjueshmëria e emisioneve të reja; Përfshirja e të rinjve në krijimin e përmbajtjeve të emisioneve	Muaji II - XII	
Krijimi i vazhdueshëm i përmbajtjeve të reja (buletineve, gazetave, shtypit, blogjeve etj) me temë për të rinj	OJQ-të Institucionet arsimore (seksionet letrare) Të rinjtë	Numri i botimeve të reja të revistave, blogjeve, buletineve, gazetave për të rinj; Tirazhi i publikimeve të ideuara; Interesimi i të rinjve për përcjelljen dhe krijimin e teksteve të reja	Muaji II - XII	2000 €
Objektivi 3:				
Lobimi për futjen e linjës së rregullt të transportit fshat-qytet	OJQ-të Të rinjtë Mediat	Fushata e organizuar për vendosjen e linjës së re të transportit e cila do të lidhte fshatin dhe qytetin	Muaji IX	
Informimi i të rinjve për mundësitë e pjesëmarrjes në programe në vend dhe jashtë vendit	Qendra Informative Shkollat OJQ-të Mediat	Numri i informacioneve në dispozicion të të rinjve	Muaji II - XII	
Organizimi i vizitave arsimore, shkëmbimeve, vizitave studimore, seminareve, programeve vullnetare etj.	OJQ-të Komuna e Ulqinit Shkollat	Numri i realizuar i vizitave arsimore, shkëmbimeve, vizitave studimore, seminareve, programeve vullnetare etj.;	Muaji II - XII	3000 €
		Numri i të rinjve të kyçur në këto programe		
Fushata për përshtatjen e institucioneve për lëvizjen e lirë të personave me aftësi të kufizuara	OJQ-të Komuna e Ulqinit Institucionet (Qendra për Punë Sociale, Shtëpia e Shëndetit, Zyra e Punës, Policia, Qendra për Kulturë...)	Numri i qytetarëve të informuar për fushatën; Gatishmëria e treguar e institucioneve për të përshtatur kapacitetet ekzistuese; Shkalla më e lartë e të kuptuarit të rëndësisë së qasjes së lirë institucioneve nga personat me invaliditet	Muaji II - XII	600 €

Grupi Punues për hartimin e Planit të Veprimit Rinor:

- Ardian Mavriq** – Komuna e Ulqinit
- Alban Gjoni** - Komuna e Ulqinit
- Ardita Rama** – Qendra për Kulturë
- Linda Kurt** – Shtëpia e Shëndetit
- Esad Mehmeti** - RTV Ulqin
- Gazmend Kalabrezi** – Gjykata Themelore Ulqin
- Hasan Gjoni** – Enti për Punësim
- Ilir Tafica** - Gjimnazi Drita
- Aida Rexhepi** - Gjimnazi Drita (nxënëse)
- Iliriana Dervishi** – Qendra Ditore për fëmijë dhe të rinj me pengesa në zhvillim „Sirena“
- Leudrita Mustafa** – Shkolla e Vallëzimit „Porta di Danza“
- Melisa Dervišaga** – Shoqata e prindërve të fëmijëve me pengesa në zhvillim
- Milena Popoviq** – Qendra për Punë Sociale
- Qazim Hoxhiq** – Organizata Turistike Ulqin
- Remzije Rejzi** – Shkolla e Mesme “Vëllazërim-Bashkim”
- Lenka Laloviq** – Shkolla e Mesme “Vëllazërim-Bashkim” (nxënëse)
- Azra Mujiq** – Veprimtare rinore
- Nazif Veliq** – OJQ „Horizont i Ri“
- Arben Husiq**– Asistent në Projekt
- Renata Blenishta** – Koordinatorë e Projektit



Komuna e Ulqinit
Blv. Gjerg Kastrioti Skenderbeu
85360 Ulqin
Telefon: +382 (0)30 412 050
Fax: +382 (0)30 412 413
www.opstinaulcinj.com

OJQ Horizonti i Ri
Kodre pn
85360 Ulqin
Telefon: +382 (0)68 300 603
E-mail: horizon@t-com.me
www.ngo-horizonti.org